



REPUBLIKA E KOSOVËS - GOVORINA KOSOVO, REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - Vlada Kosova, GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVSTVA, MINISTRY OF HEALTH
INSPEKTORATI FARMACEUTIK - FARMACEUTSKI INSPEKTORAT, PHARMACEUTICAL INSPECTORATE

Mesta Org: -10-
Org. Joditica: -5-
M. i Pajisje: -5-
M. i Prof. 05-407
M. i Prof. 03 04 25

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health

Inspektorati Farmaceutik / Farmaceutski Inspektorat / Pharmaceutical Inspectorate

Raport	
Data/Date/Datum:	13.03.2025
Për/To/ Za:	Ref. No. 10/KT-004-25
Përmes/Through/Preko:	Mr.Ph. Vjosa Hoti, themeluese dhe farmacistë përgjegjëse e Qarkulluesit Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale (barnatores) "Dr.Vjosa Hoti", Prizren
Nga/From/Od:	Mr. Sc Remzie Thaçi, Drejtor i Departamentit të IP-së Mr.Ph. Kaltrina Topalli, Inspektore farmaceutike Mr.Ph. Blerta Rexhepi, Inspektore farmaceutike Mr.Ph. Leonis Blakaj, Inspektor farmaceutik
Lënda/ Subject/Tema:	Raport i inspektimit për Qarkulluesin Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale "Dr.Vjosa Hoti" Prizren
Cc:	Dr Arben Vitia, Ministër i Shëndetësisë Dr Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm i MSh-së, Mr.Ph. Labinot Zeqiri, Zëvendësues i Detyrës së Kryeinspektorit Shëndetësor Mr.Ph. Arian Ahmeti, Zëvendësues i Detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv në AKPPM

I. Përmbledhja

Inspektorati Farmaceutik me datë 05.03.2025 ka kryer inspektim të planifikuar me qëllim të mbrojtjes së interesit/shëndetit publik në Qarkulluesin Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale (barnatoren) "Dr.Vjosa Hoti" në Prizren. Inspektimi i bazuar në Ligjin për Shëndetësi 04/L-125, Ligjin për Produkte dhe Pajisje Medicinale 04/L-190, Ligjin 08/L-220 për Çmime, Udhëzimin Administrativ për Qarkulluesit me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale 11/2015, Ligjin 05/L-087 për Kundërvajtje të Republikës së Kosovës dhe Ligjin 08/L-067 për Inspektimet. Prezent gjatë inspektimit ishte Znj Shkurte Kabashi - teknike e farmacisë me nr të licencës së punës KO-13546-05-4.

Në fund të inspektimit u përpilua procesverbali me numër 0014591 i cili i është lexuar palës dhe është nënshkruar nga pala prezente dhe inspektorët e rastit.

II. Metodologjia

Metodat e shfrytëzuara gjatë inspektimit:

- **Intervistimi:** Bashkëbisedimi me tekniken e farmacisë
- **Mbledhja e fakteve:** Licenca e barnatores, Çertifikata e biznesit, Licenca e farmacistit përgjegjës
- **Observimi:** Gjatë inspektimit janë kontrolluar dokumentacioni, prezenca e stafit profesional dhe me theks veçantë u bë monitorimi i zbatimit të Vendimit numër 208/XII/2024 të lëshuar nga Ministri i Shëndetësisë.

III. Faktet

Inspektorati Farmaceutik me datë 05.03.2025 ka kryer inspektim të planifikuar në Qarkulluesin Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale "Dr.Vjosa Hoti" në Prizren.

Janë kontrolluar dokumentacioni, prezenca e stafit profesional si dhe me theks veçantë u bë monitorimi i zbatimit të Vendimit numër 208/XII/2024 të lëshuar nga Ministri i Shëndetësisë me ç'rast u pa se pala ka filluar me vendosjen e çmimeve në produkte medicinale por për shkak të volumit të madh të produkteve ka deklaruar se ende është në proces të vendosjes së tyre.

Barnatorja u gjet e hapur dhe shërbimi farmaceutik ofrohej nga Znj Shkurte Kabashi, teknike e farmacisë e cila prezantoi licencën e punës me numër KO-13546-05-4.

Nuk u gjet prezent në barnatore farmacisti përgjegjës ose ai zëvendësues.

Përmes procesverbalit numër 0014591 pala është urdhëruar që të mbyllë barnatoren dhe të punojë vetëm në prezencën e farmacistit përgjegjës ose atij zëvendësues.

Poashtu e njëjta është obliguar që të vazhdoj të respektoj Vendimin me numër 208/XII/2024 me ç'rast procesverbali në fjalë u konsiderua masë parandaluese referuar Ligjit 08/L-067 për Inspektimet sa i përket vendosjes së çmimeve.

IV. Konstatimet

- Qarkulluesi Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale (barnatorja) "Dr.Vjosa Hoti" me seli në Prizren posedonte licencë pranë AKPPM-së me numër të Licencës L5-0326/11/06/2021 me person përgjegjës Mr.Ph. Vjosa Hoti me numër të licencës së punës RKS-1037-21 njëkohësisht pronare e barnatores.
- Barnatorja u gjet e hapur dhe shërbimi farmaceutik ofrohej nga Znj Shkurte Kabashi – teknike e farmacisë.
- Në kohën e inspektimit në barnatore nuk u gjet prezent farmacisti përgjegjës ose ai zëvendësues me ç'rast konstatohet se pala ka vepruar në kundërshtim me Paragrafin 2 të Nenit 26 të Ligjit 04/L-125 për Shëndetësi, Paragrafin 2 të Nenit 14 të Ligjit Nr.04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale, Paragrafin 3 dhe 4

të Nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (Shëndetësi) Nr. 11/2015 për Qarkulluesit Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale.

V. Rekomandimet

- Përmes procesverbalit numër 0014591 pala është urdhëruar që të mbyllë barnatoren dhe të mos ofrojë shërbim farmaceutik pa prezencën e farmacistit përgjegjës ose atij zëvendësues.
- Të vazhdohet të respektohet Vendimi me numër 208/XII/2024 me ç'rast procesverbali në fjalë u konsiderua masë parandaluese referuar Ligjit 08/L-067 për Inspektimet sa i përket vendosjes së çmimeve.
- Raportin e shoqëron Vendimi me gjobë numër 10/KT-004-25.
- Për plotësimin e rekomandimeve pala të njoftojë me shkrim Inspektoratin Farmaceutik

Raportit i bashkangjitet :
Procesverbali me numër 0014591



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

Inspektorati FARMACEUTIK

PROCESVERBAL I INSPEKTIMIT

0014591

(Nr. Serik)

05.03.2025

(Data e fillimit të inspektimit)

12:40

(Ora e fillimit të inspektimit)

Në subjektin: BARNATORE, DR. VJOSA HOTI - 15-0326/11/C6/2021
ARSK: 811 517 856 (Emërtimi i subjektit të inspektimit)

I udhëhequr nga: NR. PH. VJOSA HOTI - PRONARE SI DHE FARMACITE PËRQEN
(Emri dhe mbiemri i udhëheqësit të subjektit të inspektimit) RKS-1037-21

Në adresën: RR. WILLIAM WILKES 'KOMPLEKS' KADASHI 2 - PRISHTEN
(Adresa e subjektit të inspektimit)

Inspektimi është realizuar nga:

NR. PH. KATRINA TOPALLI
NR. PH. BUKETA BEXHEPI
NR. PH. LEONIS BLAKAJ

(Emrat dhe mbiemrat e inspektorëve dhe personave të autorizuar për inspektim)

Me numër të dokumentit të identifikimit:

NSN-1054
NSN-1054
NSN-0474

(Numri përkatës i dokumentit të identifikimit të inspektorit dhe të personave të autorizuar)

Në informatat kontaktuese: KATRINA.TOPALLI@RKS-GOV.NE

(Adresa elektronike e njërit nga inspektorët dhe numri zyrtar kontaktues)

Baza ligjore e inspektimit: LIGJI 04/11-190, LIGJI 04/11-125, LIGJI 03/11-067

Procesverbali përpilohet për: INSPEKTIM I PLANIFIKUAR

(Lloji i inspektimit)

Inspektimi është bërë: me miratim ☒

pa miratim ☐

Inspektimi është bërë pa miratim përshkak të:

(Arsyeja e inspektimit pa miratim)

(nënshkrimet e anëtarëve të trupës inspektuese)

Pranimi i miratimit të inspektimit është refuzuar nga subjekti i inspektimit: po ☐ jo ☒

Ka munguar personi përfaqësues i subjektit të inspektimit: po ☒ jo ☐

Miratimi i inspektimit është vendosur fizikisht aty ku është kryer inspektimi: po ☐ jo ☒

Arsyeja për devijimin e inspektimit nga lista e kontrollit të inspektimit është:

(mbrojtja e interesit publik, shëndëtitë publik, sigurisë publike dhe/apo e mjedisit, nëse ka ndodhur)

Është inspektuar: DOKUMENTACIONI, HAPËSIRAT, PRODUKTET DHE
PRISJET MEDICINALE, SI DHE PREZENCA E STAFIT
PROFESIONAL, NJEFINI, RRETH VENDIT 2021/11/2024, E JESURE
(objekti i inspektimit, si për shembull Hoji i dokumentacionit, i produktit, i objektit etj.) NGA NUK

Me rastin e inspektimit janë marrë:

(mostrat e produkteve, materialeve, mallrave, substancave apo prodhimeve, nëse ka ndodhur)

Gjetjet e inspektimit janë: JE KREU INSPEKTIM NË SUBJEKTIN E LARTËSEKUR,
NE CIRAST BARNATORIA U GJET E HAPUR, KU SHËRBINI FARMACIUT
ORONET NGA TEKNIKA E FARMACIUT SHKURTE KARRAN AMR
NUMER TE LICENCES: KO-13536-05-4 PREZENT NUK ISHTE
FARMACISTJA PËRGJEGJËSE APO ZËVENDËSUESË.

Pretendimet e subjektit të inspektimit janë:

(përmbledhja nga inspektori e shpjegimit dhe pretendimit të subjektit të inspektimit, pas dëgjimit të palës)

Subjekti i inspektimit ka vërejtje si vijon: NUK KAN

(vërejtjet eventuale të subjektit të inspektimit sa i përket gjetjeve të inspektimit)

Vendimet e marra janë si vijon: UROHËKOHET QË BARNATORJA TË
MARJET DHE TË OPERAJE KONFORM LEGJISLACIONIT
NË FUQI BARNATORJA TË SIGUROJE FARMACISTIN
SHKURTE SHKURTE ORONET TË PUNET KTO E PARASHET
HOJI

Inspektimi ka përfunduar më datë: 05.03.2025, në orën: 13:05

SHKURTE BEKIDA
(nënshkrimi i subjektit të inspektimit apo përfaqësuesit të tij)

KTOULLI
2025
(nënshkrimet e anëtarëve të trupës inspektuese)

(nënshkrimet e anëtarëve të trupës inspektuese)